


ANALIZË E SHKURTËR

DIALOGU KOSOVË-SERBI: NJË HAP PARA, TRE HAPA MBRAPA!



ANALIZË E SHKURTËR

DIALOGU KOSOVË-SERBI: NJË HAP PARA, TRE HAPA MBRAPA!

GUSHT, 2022

E drejta e autorit © 2022. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0) 38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Autorë: Violeta Haxholli dhe Arbër Taçi

Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit "*Shoqëritë civile në Kosovë dhe Serbi promovojnë një proces pajtimi pjesëmarrës dhe kuptimplotë*" i mbështetur nga Ministria e Itالية e Jashtme dhe për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Përmbajtja e kësaj analize është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ministrisë Itالية të Jashtme dhe për Bashkëpunim Ndërkombëtar.



TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	7
2. TAKIMET E DIALOGUT: ECJE PËRPARA, STATUS QUO APO RIKTHIM TEK TEMAT E VJETRA?	8
3. NEVOJA PËR DIALOG TË BRENDSHËM KRAHAS DIALOGUT ME SERBINË.....	11
4. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA SI ELEMENTE TË RËNDËSISHME TË PROCESIT TË DIALOGUT	13
5. PËRFUNDIM	17



1. Hyrje

Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga Bashkimi Evropian, tashmë ka mbushur më shumë se një dekadë. Të dy këto vende, ndonëse për më tepër se dhjetë vjet po negociojnë nën platformën e BE-së, ideja e bisedimeve dhe epilogut final mbetet akoma e paqartë. Me gjithë marrëveshjet e shumta përgjatë gjysmës së parë të procesit, dialogu ka prodhuar paqartësi, ndërsa dy vendet ende nuk kanë arritur një marrëveshje finale. Diskutimet në kuadër të dialogut janë zhvilluar kryesisht për tema teknike, për të cilat është diskutuar e ri diskutuar varësisht nga zhvillimet në terren. Qëllimi fillestar i dialogut ishte që të tejkalohen pengesat në mes dy vendeve, në mënyrë

që duke u angazhuar në çështje më teknike, të krijohej sinergji për marrëveshjen qendrore finale. Në çështjen e transparencës, dialogu nuk pësoi ndonjë ndryshim – mbeti kryesisht jotransparent nën menaxhimin e çfarëdo qeverie.

Me anë të kësaj analize, KDI fokusohet në tri aspektet të procesit të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, nevojën për progres drejt marrëveshjes finale, nevojën për zhvillimin e dialogut të brendshëm me komunitetin serb në Kosovë, si dhe nevojën për rritje të transparencës dhe llogaridhënies së Qeverisë ndaj Kuvendit dhe publikut të gjerë lidhur me këtë proces.



Diskutimet në kuadër të dialogut janë zhvilluar kryesisht për tema teknike, për të cilat është diskutuar e ri diskutuar varësisht nga zhvillimet në terren.



2. TAKIMET E DIALOGUT: ECJE PËRPARA, STATUS QUO APO RIKTHIM TEK TEMAT E VJETRA?

Që kur kanë rifilluar takimet e dialogut në Bruksel pas zgjedhjes së Qeverisë së re në Kosovë, temat të cilat janë diskutuar deri më tani kanë qenë liria e lëvizjes, konkretisht çështja e tabelave të veturave, energjia dhe çështja e personave të pagjetur. Pas shumë përpjekjeve palët janë dakorduar për një udhërrëfyes për zbatimin e marrëveshjes për energji¹, ndërsa ende nuk ka marrëveshje për lirinë e lëvizjes dhe personat e pagjetur. Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës ka ofruar disa propozime të reja në dialog, mirëpo ato nuk janë pranuar nga pala serbe. Në ndërkohë mbeten shumë tema për të cilat ende duhet të arrihen dakordime mes palëve, ndërsa duhet të diskutohet edhe mbi marrëveshje të cilat janë arritur shumë moti por që nuk janë zbatuar në praktikë siç është p.sh. marrëveshja e diplomave, IBM-i etj.

Edhe dakordimin e ri për udhërrëfyesin për energji duket se do ta përcjellë e njëjta praktikë e mos zbatimit. Kjo pasi që Serbia nuk i ka zbatuar pikat e udhërrëfyesit sipas afateve të përcaktuara.² Kjo situatë do t'i detyrojë palët që të diskutojnë sërish për këtë çështje.

Në ndërkohë, pas tensioneve të krijuara në veri të Kosovës, si reaksion ndaj vendimeve të Qeverisë për të zbatuar marrëveshjet për lirinë e lëvizjes, Kryeministri i Kosovës dhe Presidenti i Serbisë u ftuan për një takim në Bruksel, më 18 gusht. As ky takim nuk prodhoi ndonjë përparim domethënës në procesin e dialogut mes dy vendeve. Nga përfaqësuesit e BE-së u cilësua si takim për menaxhim të krizës, ndërsa mbetet kërkesë që palët të arrijnë normalizimin e plotë të marrëdhënieve me anë të një marrëveshje finale.³ Arritja e një marrëveshje finale ligjërish të obligueshme që ka në qendër njohjen reciproke mbetet kërkesë edhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës⁴

Derisa dialogun e kanë mbizotëruar diskutimet për çështjet teknike, palët nuk kanë rifilluar ende diskutimet në detaje lidhur me elementet e marrëveshjes finale, diskutime këto që janë ndërprerë në vitin 2020. (Shih tabelën 1.1) Një hezitim më të madh për të diskutuar mbi elementet e marrëveshjes finale duket ta ketë Serbia, sidomos për faktin që administrata Amerikane e së fundi edhe Bashkimi Evropian kanë kërkuar

1 ZKM, "Arrihet marrëveshja mbi energjinë", 21 qershor 2022, në <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/arrihet-marreveshja-mbi-energjiine/>

2 Kallxo, "Shkelja e afateve të udhërrëfyesit për zbatimin e marrëveshjes për energjinë", 6 gusht 2022, në <https://kallxo.com/krypometer/shkelja-e-afateve-te-udherrefyesit-per-zbatimin-e-marreveshjes-per-energjiine/>

3 Shih deklaratën e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së Josep Borell në, https://www.eeas.europa.eu/eeas/belgrade-pristina-dialogue-press-re-marks-high-representativevice-president-josep-borrell-after_en

4 Euro News, 15 shkurt 2022, "Biden: Dialogu Kosovë-Serbi duhet të përfundojë me njohje reciproke", në <https://euronews.al/raioni/kosove/2022/02/15/biden-dialogu-kosove-serbi-duhet-te-perfundoje-me-njohje-reciproke/>





Që kur kanë rifilluar takimet e dialogut në Bruksel pas zgjedhjes së Qeverisë së re në Kosovë, temat të cilat janë diskutuar deri më tani kanë qenë liria e lëvizjes,




Konkretisht çështja e tabelave të veturave,



energja



çështja e personave të pagjetur.



Derisa dialogun e kanë mbizotëruar diskutimet për çështjet teknike, palët nuk kanë rifilluar ende diskutimet në detaje lidhur me elementet e marrëveshjes finale, diskutime këto që janë ndërprerë në vitin 2020.

që marrëveshja finale të ketë në qendër njohjen reciproke.⁵ Lidhur me këtë, palët në dialog kanë qëllime diametralisht të kundërta. Kosova nga dialogu synon njohjen ndërsa Serbia ende nuk është shprehur e gatshme për një gjë të tillë. Kjo është konfirmuar shumë herë nga deklaratat publike të përfaqësuesve të lartë politik në Serbi, të cilët vazhdojnë të shprehen se Serbia nuk është në dialog për të njohur Kosovën. Natyrisht se arritja e një marrëveshje finale sidomos nëse ajo marrëveshje do të kishte në qendër njohjen reciproke, do të mund zgjidhte edhe çështjet tjera teknike që mbeten problematike mes dy vendeve. Psh. lëshimi i dokumenteve të përkohshme të udhëtimit gjatë

kalimit kufitar nuk do të ishte më i nevojshëm në qoftë se Kosova dhe Serbia do të arrinin një marrëveshje për njohje reciproke. Por në situatën aktuale një gjë e tillë duket vështirë e arritshme. Mendim të tillë kanë shprehur edhe qytetarët e Kosovës dhe ata të Serbisë në sondazhin që KDI ka realizuar në qershor të këtij viti. Vetëm 2,5% e të anketuarve në Kosovë dhe 2.1% në Serbi presin që të arrihet një marrëveshje finale mes dy vendeve gjatë vitit 2022.⁶

Mungesa e vullnetit politik për të ecur përpara drejt marrëveshjes finale, do të vazhdojë të reflektojë në situatën në terren, duke mbajtur një status quo të paqëndrueshme që prodhon herë pas here tensione.

⁵ Euro News, 15 shkurt 2022, "Biden: Dialogu Kosovë-Serbi duhet të përfundojë me njohje reciproke", në <https://euronews.al/rajoni/kosove/2022/02/15/biden-dialogu-kosove-serbi-duhet-te-perfundoje-me-njohje-reciproke/>

⁶ Shih sondazhin e KDI-së në <https://kdi-kosova.org/aktivitetet/sondazhi-i-kdi-se-shperfaq-pakenaqesite-e-qytetareve-te-kosoves-dhe-te-serbise-me-procesin-e-dialogut/>



Tabela 1.1: Takimet e Dialogut mes Kosovës dhe Serbisë

Takimet e dialogut mes Kryeministrit të Kosovës Albin Kurti dhe Presidentit të Serbisë Aleksandar Vuçiq		Takimet e kryenegociatorëve Besnik Bislimi dhe Petar Petkovic dhe takimet e grupeve teknike	
15 qershor 2021	Bruksel	6 korrik 2021	
19 korrik 2021	Bruksel	7 shtator 2021	
4 maj 2022	Berlin	29, 30 shtator 2021	
5 maj 2022	Berlin	16 nëntor 2021	
18 gusht 2022	Bruksel	28 janar 2022	
		22 shkurt 2022	
		11 mars 2022	
		21 prill 2022	
		13 maj 2022	
		21 qershor 2022	

Burimi: ZKM dhe profili zyrtar në Twitter i Lajçak



3. NEVOJA PËR DIALOG TË BRENDSHËM KRAHAS DIALOGUT ME SERBINË

Edhe pse një nga qëllimet kryesore të dialogut mes Serbinë ka qenë integrimi i komunitetit serb brenda sistemit të Republikës së Kosovës, pas më shumë se një dekade dialog ky integrim nuk duket të jetë ende i qëndrueshëm.

Përmes marrëveshjeve të dialogut është arritur deri diku integrimi i këtij komuniteti përbrenda administratës publike, sektorit të sigurisë dhe drejtësisë. Megjithatë, ky proces duket të jetë tejet i varur nga zhvillimet në dialogun Kosovë-Serbi dhe raportet mes dy vendeve. Një ndikim të madh në këtë drejtim e ka Beogradi zyrtar, përmes kontrollit tek individë dhe grupe që veprojnë në Kosovë të cilët ndikojnë tek qytetarët serb që janë integruar në institucionet e Kosovës, që të suspendojnë vijueshmërinë në vendet e tyre të punës. Ka pasur dhjetëra raste duke përfshirë edhe ato aktuale, kur përfaqësuesit politik të komunitetit serb në Kosovë kanë pezulluar pjesëmarrjen në Kuvendin e Kosovës dhe në Qeveri, veprim ky që është ndjekur edhe nga stafi civil serb në administratën publike.⁷

Distanca që është krijuar pas pavarësisë mes komunitetit serb në Kosovë dhe shtetit të Kosovës përgjatë viteve vetëm sa është rritur. Vakumin e krijuar mes shtetit të Kosovës dhe komunitetit serb e ka plotësuar me shpejtësi dhe në vazhdimësi Serbia duke e betonizuar dhe përdorur për qëllimet e saj destruktive.

Në anën tjetër, institucionet e Kosovës nuk iu kanë qasur me strategjinë e duhur kësaj situatë. Qeveritë i kanë neglizhuar këto zhvillime, duke i shtyrë serbët lokal faktikisht edhe më shumë drejt ndikimit të Serbisë dhe strukturave të saj sidomos në veri të vendit. Përkundër zotimeve edhe të qeverisë aktuale, për zhvillim të dialogut të brendshëm me serbët lokal, komunikimi mes institucioneve dhe qytetarëve nga ky komunitet mungon. E në mungesë të këtij komunikimi, institucionet tona nuk janë në dijeni me kërkesat dhe problemet reale me të cilat ballafaqohen qytetarët serb, si dhe se si mund të adresohen ato probleme përmes mekanizmave institucionalë të Kosovës.

⁷ Kallxo, "Lista Serbe dhe stafi gjyqësor pezullojnë punën në Kosovë", 25 mars 2022, në <https://kallxo.com/lajm/lista-serbe-dhe-stafi-gjyqesor-pezullojne-punen-ne-kosove/>



Distanca që është krijuar pas pavarësisë mes komunitetit serb në Kosovë dhe shtetit të Kosovës përgjatë viteve vetëm sa është rritur. Vakumin e krijuar mes shtetit të Kosovës dhe komunitetit serb e ka plotësuar me shpejtësi dhe në vazhdimësi Serbia duke e betonizuar dhe përdorur për qëllimet e saj destruktive.



Qeveria aktuale duhet të shtyjë përpara idenë e kahmotshme për zhvillimin e një dialogu të brendshëm me komunitetin serb. Kjo në mënyrë që të kuptohen direkt se cilat janë kërkesat e përfaqësuesve dhe qytetarëve të këtij komuniteti dhe të njëjtat të adresohen aq sa është e mundur përmes mekanizmave institucional.

Ndërsa, në raport me dialogun dhe marrëveshjet e arritura në kuadër të tij, qeveritë kanë qenë pasive në informimin e qytetarëve serb lidhur me përmbajtjen e marrëveshjeve dhe implikimeve të tyre në jetën e përditshme, duke i lënë ata me burim të vetëm të interpretimit Serbinë, që shpeshherë i ka dezinformuar dhe keqinterpretuar marrëveshjet për qëllimet e saj.

Institucionet e Kosovës janë dorëzuar para faktit që Beogradi zyrtar përmes strukturave paralele ka shtrirë ndikimin tek komuniteti serb, duke e lënë pas dore një pjesë të këtij komuniteti që është nën presion nga këto struktura dhe ashtu si shteti i Kosovës ka interesim që të lirohet nga ato dhe të jetojë një jetë normale në Kosovë. Në këtë drejtim, Qeveria aktuale duhet të shtyjë përpara idenë e kahmotshme për zhvillimin e një dialogu të brendshëm me komunitetin serb. Kjo në mënyrë që të kuptohen direkt se cilat janë kërkesat e përfaqësuesve dhe qytetarëve të këtij komuniteti dhe të njëjtat të adresohen aq sa është e mundur përmes mekanizmave institucional. Qeveria duhet të informojë këtë komunitet edhe lidhur me marrëveshjet e dialogut, shumica prej të cilave e prekin direkt jetën e këtij komuniteti. Sondazhet që ka realizuar KDI gjatë këtij viti dëshmojnë se qytetarët serb që jetojnë në Kosovë nuk kanë mjaftueshëm njohuri lidhur me përmbajtjen e marrëveshjeve të dialogut, duke përfshirë këtu edhe marrëveshjen e Asociacionit. Në pyetjen që KDI u ka drejtuar të gjithë qytetarëve në Kosovë se si e shohin marrëveshjen për Asociacionin, 50% e të anketuarve të qytetarëve të komunitetit serb janë shprehur se nuk e dinë apo nuk janë përgjigjur fare lidhur me atë se çfarë ndikimi ka kjo marrëveshje në funksionimin e shtetit të Kosovës apo të drejtat e tyre.⁸

Aktivitetet vetëdijësuese informative nga ana e Qeverisë kanë munguar edhe lidhur me vendimet e Qeverisë për zbatimin e marrëveshjeve të dialogut duke përfshirë edhe vendimin e fundit për zbatimin e pikave të marrëveshjes për lirinë e lëvizjes, konkretisht për tabelat e veturave dhe lëshimin e dokumenteve të përkohshme gjatë kalimit kufitar Kosovë-Serbi. Një argument të tillë e ka shprehur edhe Ambasada Amerikane në Kosovë në kërkesën e saj ndaj Qeverisë për të shtyrë vendimin për një muaj.⁹ Qeveria e Kosovës nuk ka bërë mjaftueshëm që tu sqarojë qytetarëve serb që ky vendim i Qeverisë është plotësisht në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit për lirinë e lëvizjes dhe është plotësisht e ngjashme me praktikën e njëjtë që ka aplikuar Serbia ndaj qytetarëve të Kosovës. Pra reciprociteti i vendosur është faktikisht reciprocitet që Serbia veçse e ka pranuar në vitin 2011 në Marrëveshjen e Brukselit për lirinë e lëvizjes. Informacionet e sakta që do duhej ti ofronte Qeveria e Kosovës për qytetarët serb i ka zëvendësuar Serbia me informacione të pasakta dhe për qëllime politike duke i trumbetuar në publik vendimet e Qeverisë së Kosovës si sulme ndaj komunitetit serb dhe duke përdorur grupet kriminale për të sulmuar policinë e Kosovës gjatë kryerjes së detyrës.

Edhe në rastet kur janë zhvilluar kampanja informuese nga ana e Qeverisë, ato janë limituar tek postimet me shkrim dhe video-mesazhe të kohëpaskohshme në rrjetet sociale, që vështirë se kanë arritur audiencën e duhur. Deri më tani nuk ka pasur kampanja më sistematike, që mund të përfshijnë vendosjen e pamfleteve informative në komunat me shumicë serbe dhe bashkëpunimin me vet komunat serbe për shpërndarjen e informacioneve në terren.

⁸ Shih sondazhin e KDI-së.

⁹ Deklarata e ambasadorit Jeffrey Hovenier për mediat kosovare, vendimet për dokumentet hyrëse/dalëse dhe targat (Ambassador Jeffrey Hovenier's statement to Kosovo media, Entry/exit documents and license plates decisions), 31 korrik 2022, në <https://xk.usembassy.gov/st731amb/?fbclid=I-wAR0X0kSJU6sk2dscjm86eUMeb4zs-bC2kCSWv2G0mIjKpvjAT5n7Wb68QU0>

4. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA SI ELEMENTE TË RËNDËSISHME TË PROCESIT TË DIALOGUT

Mungesa e transparencës pothuajse gjithmonë e ka karakterizuar procesin e dialogut Kosovë-Serbi. Përfaqësuesit politik të Kosovës në këtë proces kryesisht kanë hezituuar që ta informojnë Kuvendin si institucioni më i lartë mbikëqyrës i politikës së jashtme, shoqërinë civile e publikun e gjerë lidhur me zhvillimet në kuadër të dialogut. Edhe pse pothuajse pas çdo takimi me Serbinë ish kryeministrat e Kosovës kanë raportuar në Kuvend, raportimet e tilla kanë qenë kryesisht sipërfaqësore, ndërsa shumë informacione nuk janë ndarë në emër të konfidencialitetit të procesit. Marrëveshjet e dialogut janë prezantuar para Kuvendit dhe publikut vetëm pasi janë arritur ndërsa shpesh herë teksti i tyre nuk është publikuar me kohë në ueb faqen zyrtare të Qeverisë, siç ka ndodhur p.sh me marrëveshjen e drejtësisë. Aktualisht, në ueb faqen zyrtare të Qeverisë marrëveshjet dhe raportet rreth dialogut janë vështirë të qasshme sepse ato janë të shpërndara në disa seksione të ndryshme. Disa informacione nuk janë shtuar siç është p.sh. Raporti i fundit i Qeverisë lidhur me gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve. Një hapësirë apo seksion i veçantë në ueb faqen e Qeverisë, ku do të paraqiteshin të gjitha marrëveshjet dhe dokumentet rreth dialogut do ta lehtësonte qasjen e publikut në marrjen e informacioneve rreth kësaj çështje.

Qeveria e re, ka zgjedhur një qasje tjetër sa i përket informimit të Kuvendit dhe publikut rreth dialogut me Serbinë. Si fillim, zyrtarët e Qeverisë kanë deklaruar se nuk do ta publikojnë platformën apo strategjinë e dialogut siç kanë bërë qeveritë e kaluara sepse publikimi i tyre mund të dëmtojë pozicionin e Kosovës në këtë proces.¹⁰ Ndonëse konfidencialiteti i procesit është element i rëndësishëm, Qeveria mund të jetë më transparente lidhur me dialogun deri në atë pikë ku nuk dëmtohet pozicioni i Kosovës në këtë proces.

Duke respektuar edhe mandatin e Kuvendit si institucioni më i lartë mbikëqyrës, duhet të ketë raportime të Qeverisë me vetiniciativë pas çdo takimi të zhvilluar në kuadër të dialogut. Kjo kërkesë buron edhe nga dispozitat kushtetuese të konfirmuara në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese e cila ka qartësuar kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve lidhur me politikën e jashtme.¹¹ Përveç në aktin më të lartë, Kuvendi me anë të rezolutave të miratuara në të kaluarën ka kërkuar nga kryeministrat që të raportojnë në mënyrë të rregullt rreth takimeve me Serbinë.¹² Partia që udhëheq tani me Qeverinë, si opozitë ka qenë shumë e zëshme ndaj qeverive që të garantojnë transparencë dhe llogaridhënie të procesit të dialogut.

¹⁰ Kallxo, "Opozita ia kërkon 'strategjinë' për dialogun, Bislimi: S'ia humbi vetes propabilitetin në proces duke dalë me tupan me folë", 18 korrik 2022, në <https://kallxo.com/lajm/opozita-ia-kerkon-strategjine-per-dialogun-bislimi-sia-humbi-vetes-propabilitetin-ne-proces-duke-dale-me-tupan-me-fole/>

¹¹ Shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/06/ko_43_19_agj_shq.pdf




¹² Shih Rezolutat rreth Dialogut Kosovë-Serbi në Platformën e KDI-së Vota Ime në, <http://www.votaimo.org/Public/DraftLaws#resolutions>

Deri më tani kryeministri Kurti me vetinciativë ka raportuar vetëm një herë lidhur me dialogun në seancën e 11 qershorit 2021, ku është prezantuar raporti i përditësuar i gjendjes së zbatimit të marrëveshjeve të dialogut. Nga ajo kohë kanë kaluar më shumë se një vit dhe ende nuk është publikuar një raport i ngjashëm i përditësuar dhe nuk dihet se cili është statusi aktual i gjendjes së zbatimit të marrëveshjeve të dialogut. Përditësimi i një raporti të tillë do t'i shërbente edhe Qeverisë për të adresuar në

takimet e dialogut marrëveshjet që nuk po zbatohen nga pala serbe.

Ndërsa deklaratimet tjera në Kuvend të kryeministrit lidhur me dialogun kanë qenë në kuadër të pyetjeve parlamentare apo debateve për tema tjera të zhvilluara në Kuvend gjatë së cilave është ngritur edhe tema e dialogut me Serbinë. (Shih tabelën 1.2)

Tabela 1.1: Raportimet e Qeverisë rreth Dialogut në seancat e Kuvendit

Data	Pika e seancës	Detajet
11 qershor 2021	Diskutim mbi ecurinë e deritanishme të procesit të dialogut me Serbinë	Qeveria ka prezantuar Raportin për gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të Dialogut
25 shkurt 2022	 Debat parlamentar në lidhje me zhvillimet në dialogun Kosovë – Serbi	U diskutua për Dialogun në përgjithësi
16 mars 2022	 Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me zhvillimet në dialogun Kosovë – Serb	Rezoluta e inicuar nga AAK nuk ishte miratuar
12 prill 2022	 Debat parlamentar për politikën e jashtme	U diskutua për Dialogun në përgjithësi

Burimi: www.votaim.org

Në anën tjetër, zëvendës kryeministri Besnik Bislimi ka raportuar disa herë në komisione parlamentare, disa prej të cilave janë mbyllur për publikun për shkak të informacioneve siç i ka cilësuar ai konfidenciale lidhur me dialogun. Që nga koha kur është zgjedhur Qeveria Kurti, Zëvendëskryeministri Bislimi ka raportuar lidhur me dialogun katër herë në komisionet parlamentare respektive që kanë trajtuar temën e dialogut me Serbinë. Ndërsa, përveç raportimeve specifikisht për këtë temë, ai i ka informuar komisionet lidhur me zhvillimet në dialog edhe në kuadër të diskutimeve mbi çështje tjera në 9 raste. (Shih tabelën 1.3) Ndërsa ashtu si kryeministri Kurti edhe zëvendëskryeministri Bislimi është deklaruar lidhur

me dialogun në kuadër të pyetjeve parlamentare nga deputetët.

Tabela 1.3: Raportimet e Qeverisë rreth Dialogut në Komisionet e Kuvendit

Data	Pika e rendit të ditës	Komisioni
Raportimet konkretisht për Dialogun		
5 maj 2021	 Raportim i Zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi	Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
21 shtator 2021	 Raportim i Zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi	Komisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, viktimat e dhunës seksuale të luftës, për persona të pagjetur dhe peticione
7 tetor 2021	 Raportimi i kryetarit të Komisionit Qeveritar për të Pagjeturit Andin Hoti	Komisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, viktimat e dhunës seksuale të luftës, për persona të pagjetur dhe peticione
21 prill 2022	 Raportim i Zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi	Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
23 maj 2022	 Raportim i Zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi	Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Raportimet për çështje tjera ku u ngrit edhe Dialogu		
2 qershor 2021	 Raportim i Zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi	Komisioni për Integrim Evropian
2 korrik 2021	 Raportim i Zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi	Komisioni për Integrim Evropian
14 korrik 2021	 Raportim i Zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi	Komisioni për Integrim Evropian
24 shtator 2021	 Raportim i Zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi	Komisioni për Integrim Evropian
15 tetor 2021	 Raportim i Zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi	Komisioni për Integrim Evropian



Data	Pika e rendit të ditës	Komisioni
12 nëntor 2021	 Raportim i Zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi	Komisioni për Integrim Evropian
30 nëntor 2021	 Raportim i Zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi	Komisioni për Integrim Evropian
22 mars 2022	 Raportim i Zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi	Komisioni për Integrim Evropian
18 korrik 2022	 Raportim i Zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi	Komisioni për Integrim Evropian

Burimi: www.votaime.org



PËRFUNDIM

Vendimi i ri i Qeverisë së Kosovës për të zbatuar marrëveshjen për lirinë e lëvizjes e arritur fillimisht në vitin 2011 e më pas edhe në vitin 2016, i rikthei palët në tryezën e dialogut me 18 gusht të këtij viti për të disatën herë me radhë. Kjo për shkak të qëndrimeve të Serbisë mbi këtë çështje dhe nevojës për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme. Por liria e lëvizjes është vetëm një nga shumë çështje për të cilat palët duhet të arrijnë dakordime. Ende mbeten shumë tema të cilat duhet të diskutohen, duke përfshirë këtu edhe elementet e marrëveshjes finale, ndërsa shumë marrëveshje të arritura në të kaluarën nuk zbatohen në praktikë kryesisht për shkak të mungesës së një dakordimi final. Një marrëveshje finale do të mund të kishte një efekt domino në zgjidhjen e çështjeve kontestuese mes Kosovës dhe Serbisë.

Në ndërkohë Qeveria e Kosovës duhet sa më parë të zhvillojë një dialog të brendshëm me komunitetin serb në Kosovë, duke synuar rritjen e komunikimit dhe bashkëpunimit me qëllim garantimin e integritetit të qëndrueshëm të këtij komuniteti në shtetin e Kosovës. Lidhur me vendimet që prekin qyetarët e komunitetit serb në Kosovë, Qeveria e Kosovës duhet të organizojë kampanja sistematike të informimit në terren. Në këtë drejtim duhet të ketë bashkëpunim me komunat serbe për shpërndarjen e informacioneve tek ky komunitet.

Përveç kësaj, Qeveria duhet të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e procesit të dialogut ndaj Kuvendit dhe publikut duke rritur numrin e raportimeve në Kuvend me vetinciativë dhe duke lehtësuar qasjen në informatat rreth dialogut për publikun në uebfaqen zyrtare. Në këtë drejtim, duhet të ketë raportim sistematik të përfaqësuesve të lartë të Qeverisë lidhur me takimet e zhvilluara në kuadër të dialogut. Ndërsa, raportet e përditësuara të gjendjes së zbatimit të marrëveshjeve të dialogut duhet të hartohen dhe të ndahen me Kuvendin dhe publikun.

